



Datë: 22.06.2020

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Fushë-Kosovës u bën thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat veprimtarinë e vet e zhvillojnë në komunën e Fushë-Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projekt-propozimet.
 - 1.1 Buxheti i mbështetjes financiare për organizata jo-qeveritare është 45,625,00€, nga kategoria e subvencioneve për projekte dhe individ.
 - 1.2 Shuma minimale e mbështetjes financiare është 500.00€, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5,000.00 €;
2. Në përputhje me këtë thirrje publike, organizatat jo-qeveritare dhe personat fizik (individë), mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e kulturës, rinisë dhe sportit në këto lëmi:
 - 2.1 Organizimin e ngjarjeve për promovimin e vlerave kulturore, festivale e manifestime kulturore, muzikë, botime, kinematografi;
 - 2.2 Organizimin e aktiviteteve me karakter bashkëpunimi dhe që merren me promovimin e vlerave për rininë dhe zhvillimin e aktiviteteve rinore;
 - 2.3 Organizimin e veprimtarisë dhe aktiviteteve rekreative dhe sportive për funksionimin e klubeve sportive dhe sportistë në sporte individuale.
3. Numri i organizatave jo-qeveritare që do të përkrahen është i kufizuar me limitin buxhetor të mjeteve financiare në dispozicion për shpenzim në kategorinë e subvencioneve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit:
4. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me më së shumti një projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në njërën nga fushat prioritare sipas thirrjes;
 - 4.1 Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi një ditë dhe maksimumi gjashtë muaj.
 - 4.3 Organizatat jo-qeveritare duhet të kenë të kryera transaksionet financiare sipas legjislacionit në fuqi në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë të përmbushura detyrimet ndaj Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;
5. Të drejtë aplikimi për projektet e tyre kanë organizatat jo-qeveritare që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në komunën e Fushë-Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike.

6. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularin e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim, që do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare në ueb-faqen e Komunës, linku <https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>, ndërsa thirrjet për sqarime dhe çështje tjera që lidhen me aplikimin mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike në email adresën fatlum.berisha@rks-gov.net.

7. Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetje financiare është pesëmbëdhjetë ditë pune dhe fillon nga data 22.06.2020 dhe përfundon me datë:13.07.2020.

8. Vërejtje: Organizatat jo-qeveritare dhe personat fizik, përfitues të mbështetjes financiare, 15 ditë pas përfundimit të projektit obligohen të dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar me dëshmi të faturave të rregullta me kupon fiskal, dëshmitë e pagesës, pagave dhe kontributeve.

Aplikimet (dokumentacionet) e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen nga Komisioni Vlerësues.

Dokumentet e thirrjes publike

1. Formulari i projekt-propozimit (i plotësuar në mënyrë elektronike)
2. Formulari i propozim buxhetit (i plotësuar në mënyrë elektronike)
3. Kopja e certificate së regjistrimit të OJQ-së (e skanuar)
4. Kopja e certificate së numrit fiskal (e skanuar)
5. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit (e skanuar)
6. Vertetimi i Administrates Tatimore

Vërejtje/Sqarim/Kujdes

Aplikimet (dokumentacet) e pa kompletuar nuk do të shqyrtohen nga Komisioni Vlerësues.